



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA  
DEPARTAMENTI I PIKTURËS

RREGULLORE  
E PROGRAMIT TË STUDIMEVE TË CIKLIT III  
DOKTORATURË  
“NE ARTET PAMORE”

PËR FITIMIN E GRADËS SHKENCORE “DOKTOR” NË ARTET E BUKURA  
NË PROGRAMIN E STUDIMIT TË FAB PRANË NJËSISË BAZË  
“PIKTURË”

NË FAKULTETIN E ARTEVE TË BUKURA


Miratuar me Vendimin Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ të

Senatit Akademik të Universitetit të Arteve



**KREU I**  
**Dispozita të përgjithshme**  
**Neni 1**  
**Baza Ligjore**

Rregullorja e programit të studimit për fitimin e gradës shkencore “Doktor” në Artet e Bukura, pranë njësisë bazë Pikturë (DP), për të gjitha programet e studimit në Fakultetin e Arteve të Bukura (FAB) të Universitetit të Arteve (UARI), mbështetet në Ligjin Nr. 80, datë 22/07/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, VKM Nr. 112, datë 23. 02. 2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të Standarteve Shtetërore për fitimin e Titujve Akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar; UMASR Nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL” VKM Nr. 777, datë 26.12.2018, “Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”, i ndryshuar; VKM Nr. 75, datë 12.2.2018, “Për Miratimin e Modelit të Financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor”; UMASR Nr.52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar; Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe atij të Financave dhe Ekonomisë Nr 20, datë 20.9.2019 "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor"; UMASR Nr. 29, datë 18.12.2019 “Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë”, UMASR Nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të arsimit të Lartë” i ndryshuar; UMASR Nr. 10, datë 30.3.2020 "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor"; Statutin e Universitetit të Arteve Tiranë, si dhe VKM Nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”.



## Neni 2

### Qëllimi dhe Objektivat e Programit të Studimit të Doktoratës në Artet e Bukura

1. Programi i studimeve të doktoratës në Artet e Bukura që ofrohet nga njësia bazë e Piktura për të gjitha programet e studimit, në Fakultetin e Arteve të Bukura në UART, është një program i studimeve të ciklit të tretë, me karakter akademik, i cili ka në bazë kërkimin shkencor dhe projektin artistik si dhe veprimtarinë krijuese të pavarur në fushën e përcaktuar nga njësia bazë e Pikturës për të gjitha programet e studimit në FAB.
2. Programi i Studimeve të Doktoratës në Artet e Bukura për qëllim të formojë studiues të kualifikuar në fushën e Arteve të Bukura, si piktorë, grafik desing, fashion moda, tekstil, skulptorë, fotografë, montazh, multimedia, trashëgimi kulturore, kritikë të arteve të bukura, zejeetj., të cilët do të kenë përgatitjen e duhur për t'ju përgjigjur kërkesave lidhur me zhvillim të artistik-kulturor në vend sikurse dhe bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar.
3. Studentët e diplomuar në këtë program do të kenë zhvilluar aftësi në hartimin dhe implementimin e projekteve kërkimore, studimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore kombëtare dhe ndërkombëtare, gjykimin bazuar në një këndvështrim kritik të zhvillimeve aktuale në artin shqiptar dhe më gjerë sikurse dhe kërkesave në rritje të tregut të punës sipas profilizimeve të ngushta të fushave kërkimore sipas programeve të studimit në FAB.
4. Rregullorja e programit të studimit në Artet e Bukura, përcakton misionin e studimeve, organizimin e brendshëm, mënyrën e funksionimit të programit si dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve pjesëmarrëse, raportet midis tyre, vendos procedurat dhe kriteret për pranimin e studentëve në këtë program studimi, për strukturimin e programit, rregullat e procesit mësimor dhe kërkimor për mbrojtjen e tezës si dhe parashikon sanksionet në rastin kur shkelet kjo Rregullore.

## Neni 3

### Ofrimi i programit

1. Programi i studimit Doktoratë në Artet e Bukura do të ofrohet në Universitetin e Arteve, pranë Fakultetit të Arteve të Bukura, për të gjitha programet e studimeve në FAB, dhe administrohet nga Njësia Bazë e Pikturës.
2. Përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e programit të studimit të ciklit të tretë për fitim të gradës shkencore “Doktor” është Komisioni i Përhershëm për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” i ngritur nga FAB.



3. Në përfundim të studimeve, studenti fiton gradën shkencore “Doktor” në fushën e Arteve të Bukura

#### **Neni 4**

#### **Përgjegjësitë e njësisë bazë Pikturë**

1. Njësia Bazë e Pikturës është struktura përgjegjëse për zhvillimin e punës për kërkimin shkencor, për hapjen dhe riorganizimin e programit të Doktoratës dhe ndjekjen e të gjitha fazave të procesit të Doktoratës.
2. Njësia Bazë e Pikturës, në bashkërendim me Njësitë Bazë në FAB, përcakton fushat e kërkimit ku do të zhvillohen projektet e Doktoratës.
3. Njësia Bazë e Pikturës, në bashkërendim me Njësitë Bazë në FAB, shqyrton listën paraprake të kandidatëve fitues dhe ja përcjell Dekanit të Fakultetit për miratim.
4. Njësia Bazë e Pikturës, në bashkërendim me Njësitë Bazë në FAB, miraton, paraprakisht, udhëheqësit e punimeve të doktoratës.
5. Njësia Bazë e Pikturës ka përgjegjësi t'u sigurojë studentëve doktorantë lehtësitë e nevojshme administrative për marrjen e informacionit dhe të literaturës së nevojshme kërkimore – shkencore pranë institucioneve publike dhe private.
6. Njësia Bazë e Pikturës, në bashkërendim me Njësitë Bazë në FAB, ka përgjegjësi të garantojë përmbushjen e kriterëve formale nga kandidatët, përpara shqyrtimit të dosjes së tyre nga Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Doktor.
7. Njësia Bazë e Pikturës në bashkërendim me Njësitë Bazë në FAB, ka përgjegjësi të shqyrtojë raportet e ecurisë së kërkimit shkencor, të paraqitura nga studentët dhe udhëheqësit dhe të garantojë se udhëheqësit kanë kontakt të rregullt me studentët. Në raste kur konstaton probleme, propozon ndryshimet e nevojshme.
8. Njësia Bazë e Pikturës, në bashkërendim me Njësitë Bazë në FAB, ka përgjegjësi të informojë studentët e pranuar në programin e saj të doktoratës për aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, përfshirë edhe këtë rregullore, që lidhet me procesin e fitimit të gradës shkencore.

#### **KREU II**

#### **Organet Drejtuese, Komisionet dhe Stafi akademik**

#### **Neni 5**

**Komisioni i përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor” në Artet e Bukura**



1. Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Doktor shkencore “Doktor” në Artet e Bukura, është Komisioni i përhershëm që ngrihet në nivel të njësisë kryesore sipas fushës së programit të studimit në të cilën ofrohet programi i studimit. Ai është përgjegjës për monitorimin e të gjithë procesit të dhënies së gradës shkencore “Doktor” në Artet e Bukura.
2. Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në Artet e Bukura është përgjegjës për të vlerësuar dosjen e kandidatit, ngritjen e jurisë dhe për të marrë vendime për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.
3. Detyrat e Komisionit të përhershëm për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” në Artet e Bukura janë:
  - a) Të zgjedhë Koordinatorin e programit të Doktoratës në FAB
  - b) Të miratojë planin e zhvillimit të punimeve të doktoratës dhe detyrimet vjetore sipas planit të punës.
  - c) Të ngrerë jurinë e mbrojtjes së doktoraturës bazuar në propozimin e Njësisë Bazë e Pikturës në bashkërendim me Njësitë Bazë në FAB, sipas fushës së studimit në të cilën ofrohet programi i studimit, të miratuar nga Dekani i FAB.
  - d) Të garantojë të drejtat dhe liritë akademike të doktorantëve dhe udhëheqësve shkencorë, të kategorisë profesor.
  - e) Të sigurojë që kryerja dhe vlerësimi i të gjitha veprimtarive në kuadër të doktoratës të bëhet në përputhje me standartet e institucionit, që garantojnë cilësinë dhe transparencën duhur, në varësi nga programi i studimit në të cilin ofrohet studimi.
  - f) Të vlerësojë zhvillimin e punimeve të doktoratës dhe përmbushjen e detyrimeve në përputhje me planin e miratuar.
  - g) Të miratojë Udhëheqësin Shkencor në varësi të programit të studimit të FAB, mbas miratimit nga Njësia Bazë e Pikturës në bashkërendim me Njësitë e tjera Bazë në FAB, ku zhvillohet programi i doktoratës.
  - h) Të shpallë listën përfundimtare të kandidatëve duke përcaktuar fituesit sipas renditjes, në varësi të numrit të kuotave.
4. Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” përbëhet nga 5 anëtarë të cilët i përkasin kategorisë “Profesor” dhe janë pjesë e asamblesë së personelit akademik të FAB.
5. Anëtarët e Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në Artet e Bukura, vetëkandidohen dhe përzgjidhen nga asambleja e personelit akademik, të Fakultetit. Ata kanë mandat dyvjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.



6. Kryetari i Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në Artet e Bukura zgjidhet një prej anëtarëve të këtij komisioni. Ai përzgjidhet me votim të hapur në mbledhjen e parë të këtij Komisioni nga vetë anëtarët e tij dhe ka një mandat dyvjeçar. Kryetari i Komisionit të përhershëm mund të shkarkohet me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të tjerët të Komisionit, bazuar në propozimin e njërit prej tyre.
7. Të gjitha vendimet e Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor” në Artet e Bukura hyjnë në fuqi pasi janë aprovuar nga anëtarët me shumicë të thjeshtë votash.

## **Neni 6**


### **Komisioni i Pranimi të dosjes së aplikantëve**

1. Komisioni i Pranimi të kandidatëve në studimet e doktoratës ngrihet nga Përgjegjësi i Njesisë Bazë i Pikturës, në bashkërendim me Njësitë Bazë në FAB.
2. Komisioni i Pranimi përbëhet të paktën nga 5 (pesë) anëtarë që përfaqësojnë programet e studimit në FAB.
3. Dekani i FAB, bazuar në propozimin e Përgjegjësit të Njesisë Bazë të Pikturës, miraton Komisionin e Pranimi të kandidatëve dhe emëron Kryetar të tij një nga anëtarët e këtij komisioni.
4. Anëtarët e Komisionit të Pranimi duhet ti përjasin kategorisë Profesor ose të kenë së paku gradën “Doktor” të fituar në një nga vendet e OECD.
5. Në rastet e doktoraturave ndër-institucionale, anëtarë të Komisionit të Pranimi mund të jenë edhe pjesëtarë të stafit akademik të institucionit partner me kusht që të përmbushin kriteret sipas parashikimeve të këtij neni pika 4.
6. Në përfundim të vlerësimit të aplikimeve të kandidatëve të regjistruar, Komisioni i Pranimi të dosjes së aplikantëve ja përcjell vlerësimin e bërë sipas rendit zbritës, Dekanit të FAB i cili më pas shpall listën fituese.

## **Neni 7**

### **Komisioni i Vlerësimeve të Pjeshme të ecurisë së programit**

1. Komisioni i Vlerësimeve të Pjeshme (KVP) të Doktoratës përbëhet së paku nga 3 (tre) deri 5 (pesë) anëtarë.
2. Përgjegjësi i Njesisë Bazë të Pikturës, në bashkërendim me Njësitë Bazë në FAB, propozon anëtarët e Komisionit të Vlerësimeve të Pjeshme të studimeve të Doktoratës në Artet e Bukura, dhe ia përcjell për miratim Komisionit të përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.




3. Anëtarët e KVP-së duhet të jenë specialistë të fushës specifike sipas programeve të studimit të FAB dhe kanë të paktën gradën shkencore “Doktor” të fituar në vendet e OECD ose ti përkasin kategorisë “Profesor”.
4. Të paktën një nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimeve të Pjesëshme, përjashtimisht rasteve kur mban gradën “Doktor” të fituar në një prej vendeve të OECD, duhet që përveç titujve akademikë Profesor dhe Profesor i Asociuar, të ketë edhe gradën shkencore “Doktor”.
5. KVP-ja, mbledhet të paktën një herë në vit dhe shqyrton ecurinë e punës së doktorantit në Programin e Kërkimit Shkencor.
6. Bazuar në progres-raportin e Udhëheqësit Shkencor dhe Bashkudhëheqësit (nëse ka), sikurse dhe plotësimin e detyrimeve nga ana e doktorantit sipas planit të punës, dhe referimin e doktorantit, KVP-ja gjykon nëse doktoranti mund të vazhdojë ose jo programin e doktoraturës në vitin pasardhës. Në rastin e përsëritur, më shumë se një herë, të mosplotësimit të rekomandimeve të KVP-së, ky i fundit mund të marrë vendim për çregjistrimin e kandidatit nga programi i doktoraturës dhe ja përcjell për vendimmarrje Komisionit të përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor”.
7. KVP-ja jep rekomandime për ecurinë e punës së doktorantit dhe vë në dijeni Komisionin e përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor”.

## **Neni 8**

### **Juria e Mbrojtjes së Temës së Doktoratës**

1. Juria e mbrojtjes së temës së doktoratës propozohet nga Njësia Bazë e Pikturës, në bashkërendim me Njësitë në FAB në varësi të programit të studimit dhe miratohet nga Komisioni i përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor”.
2. Njësia Bazë e Pikturës në bashkërendim me Njësitë Bazë në FAB propozon së paku 8 (tetë) anëtarë, të cilët, pas miratimit nga Dekani i FAB, i përcillen Komisionit për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.
3. Juria e mbrojtjes së temës së doktoratës ngrihet nga Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Doktor "Doktor" dhe ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët, të paktën 2 (dy) anëtarët jashtëm i përkasin Njësive Bazë brenda FAB apo edhe të fakulteteve të tjera të UARIT ose nga institucione homologe, vendase ose të huaja.
4. Anëtarët e Jurisë për Mbrojtjen e Gradës Shkencore “Doktor” duhet të kenë gradën shkencore “Doktor” të fituar në vendet e OECD dhe ti përkasin stafit akademik të kategorisë “Profesor”.



5. Të paktën 2 nga anëtarët e Jurisë duhet të ketë gradën “Doktor” të fituar në vendet e OECD ose gradën “Doktor” dhe titujt akademikë Profesor ose Profesor i Asociuar.
6. Dy anëtarë të jurisë caktohen oponentë për vlerësimin e disertacionit, njëri prej të cilëve i përket Njësive Bazë brenda FAB apo të fakulteteve të tjera të UART ose nga institucione homologe brenda ose jashtë vendit.

## **Neni 9**


### **Udhëheqësi Shkencor**

1. Programi i studimit “Doktor”, do të zhvillohet nën drejtimin e Udhëheqësit Shkencor. Për rastet të veçanta kandidati, ose Udhëheqësi Shkencor, mund të kërkojnë caktimin e një Bashkudhëheqësi.
2. Udhëheqësi Shkencor në varësi të programit të studimit të FAB, angazhohet nga Njësia Bazë e Pikturës, në bashkërendim me Njësitë Bazë në FAB bazuar në propozimin e kandidatit për doktorant dhe miratimin e Komisionit të përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor”.
3. Udhëheqësi Shkencor duhet të ketë titullin “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”.
4. Udhëheqësi Shkencor i Doktoratës është anëtar i stafit akademik të Njësive Bazë të FAB, por mund të vijë edhe nga IAL të tjera, ose Qendra Kërkimore, brenda ose jashtë vendit.
5. Në rastet kur programi i doktoratës zhvillohet në bashkëpunim/bashkërisht me IAL të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, SHBA - ve dhe Kanada - së, udhëheqësi mund të jetë pedagog i institucionit të huaj partner dhe ti përkasë kategorisë “Profesor”.
6. Udhëheqësi Shkencor duhet të jetë specialist i fushës në të cilën kandidati synon të realizojë punën e tij kërkimore.
7. Angazhimi i Udhëheqësit Shkencor kryhet mbi bazën e një kontrate të lidhur mes tij, Komisionit të përhershëm për Dhënien e Gradës shkencore “Doktor”, Njësive Bazë të Pikturës dhe Dekanit të FAB. Në kontratë parashikohen të drejtat dhe detyrimet e secilës palë për të gjithë periudhën e studimeve si dhe mënyrën e shpërblimit financiar.

## **Neni 10**

### **Detyrimet e Udhëheqësit Shkencor**

1. Udhëheqësi Shkencor ka detyrimin që të garantojë zbatimin e të gjitha rregullave të udhëheqjes së punës kërkimore të doktoraturës.
2. Ai duhet të mundësojë kandidatit mbështetjen dhe këshillimin e duhur në përmbushjen e standarteve më të larta të realizimit të punës kërkimore brenda afateve të parashikuara.





3. Udhëheqësi Shkencor i doktoratës duhet të mbajë takime të rregullta me kandidatin për të konsultuar ecurinë e punës.
4. Në rastet e bashkë udhëheqjes, udhëheqësi dhe bashkudhëheqësi duhet të mbajnë kontakte të rregullta pasi të kenë rënë dakord për përgjegjësitë e secilit prej tyre.
5. Udhëheqësi Shkencor duhet të monitorojë dhe vlerësojë rregullisht progresin e studentit, bazuar në planin e punës së dorëzuar, përkundrejt standardit të kërkuar. Të vetëdijësojë Faqe 8 studentin nëse puna e tij është nën standardin e kërkuar dhe të ndërmarrë veprimet e duhura mbështetëse.
6. Të ndihmojë studentin në përgatitjen e referateve dhe publikimeve sipas planit të punës.
7. Të vërtetojë se, vërejtjet dhe rekomandimet e Jurisë, Komisionit të Vlerësimeve të Pjesëshme, komisioneve ad hoc dhe Komisionit të përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor”, lidhur me kërkimin janë trajtuar në mënyrën e duhur nga kandidati.
8. Të nxisë studentin që të botojë pjesë nga kërkimi i tij.
9. Udhëheqësi Shkencor duhet të hartojë progres-raporte rreth ecurisë së punës. Këto progres raporte duhet ti dorëzohen Koordinatorit, i cili ia përcjell Komisionit të Vlerësimeve të Pjesëshme, bazuar në planin e punës së aprovuar dhe jo më vonë se përfundimi i çdo viti akademik.
10. Udhëheqësi Shkencor, në bashkëpunim me kandidatin për doktorant dhe, sipas rastit, Bashkudhëheqësin, hartojnë planin e punës së zhvillimit të doktoratës.


### **Neni 11**

#### **Bashkudhëheqësi**

1. Bashkudhëheqësi ka detyrimin që të garantojë zbatimin e të gjitha rregullave të udhëheqjes së punës kërkimore dhe realizimit të Temës së Dizertacionit.
2. Ai duhet ti mundësojë kandidatit mbështetjen dhe këshillimin e duhur në përmbushjen e standarteve më të larta të realizimit të kërkimit sipas parashikimeve të kontratës.
3. Bashkudhëheqësi duhet të mbajë takime me studentin dhe Udhëheqësin Shkencor për të konsultuar ecurinë e punës. Faqe 99
4. Të ndihmojë studentin në përgatitjen e prezantimeve të ndryshme në konferenca, prezantime publike etj.

### **Neni 13**

#### **Zëvendësimi i Udhëheqësit Shkencor dhe Bashkudhëheqësit**



1. Zëvendësimi i Udhëheqësit Shkencor dhe Bashkudhëheqësit kryhet me vendim të Komisionit të përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor”, pas miratimit të Njesisë Bazë pranë të cilës zhvillohet programi i studimeve të doktoratës.
2. Udhëheqësi Shkencor dhe Bashkudhëheqësi mund të zëvendësohen nëse përmbushet të paktën një nga kriteret e poshtëshënuara:
  - a. Dorëheqja e argumentuar Udhëheqësit Shkencor dhe/ose Bashkudhëheqësit.
  - b. Kërkesë e kandidatit, e argumentuar, për zëvendësim të Udhëheqësit Shkencor dhe/ose Bashkudhëheqësit.
  - c. Konstatim i konfliktit të interesit.
3. Proçedurat e ndjekura për të gjitha rastet e parashikuara nga gërma a, b dhe c të këtij Neni, Pika 2, përcaktohen në kontratën e Udhëheqësit Shkencor, Bashkudhëheqësit dhe kandidatit për gradën shkencore “Doktor”.

#### **Neni 14**

#### **Koordinatori i programit të Doktoratës**

1. Koordinatorin e programit të Doktoratës mbikëqyr zhvillimin e programit kërkimor të Doktoratës pranë Njesisë Bazë të Pikturës, në bashkërendim me Njësitë Bazë në FAB.
2. Komisioni i përhershëm për dhënien e Gradës shkencore Doktor, bazuar në propozimin e Njesisë Bazë të Pikturës në bashkërendim me Njësitë Bazë në FAB, zgjedh me shumicë të thjeshtë Koordinatorin e programit të Doktoratës i cili është staf akademik me kohë të plotë pranë Njesisë kryesore të FAB.
3. Detyrimet dhe përgjegjësitë e Koordinatorit të Programit të Doktoraturës janë:
  - a. Të hartojë çdo vit një listë me temat që janë në proçes për fitimin e gradës Doktor.
  - b. Të monitorojë proçesin e caktimit të Udhëheqësve Shkencorë për të gjithë kandidatët.
  - c. Të sigurojë respektimin e mos tejkalimit të temave në ngarkim të udhëheqësit bazuar në titullin akademik dhe mënyrën e angazhimit të këtij të fundit.
  - d. Të marrë në dorëzim raportet e progresit të kërkimit të paraqitura nga studentët dhe udhëheqësit dhe ti dorëzojë pranë Komisionit të Vlerësimeve të Pjeshme. Të garantojë Faqe 10 se udhëheqësi/t ka/në kontakt të rregullt me studentët. Në rastet kur konstaton



- probleme, ti propozojë Komisionit të përhershëm për dhënien e Gradës Doktor ndryshimet e nevojshme.
- e. Të organizojë për çdo vit Forumin e Doktoratës.
  - f. Të raportojë pranë Komisioneve të Vlerësimit të Pjesëshëm për realizimin e Përmbajtjes Shkencore nga kandidati/tët për gradën shkencore “Doktor”.
  - g. Të mbajë kontakt me studentët e doktoratës lidhur me shqetësime të ndryshme që ata mund të kenë.
  - h. T’u bëjë të gjithë studentëve të njohur të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore, udhëzime, rregullore etj., që kanë lidhje me procesin e fitimit të gradës shkencore Doktor.
  - i. Koordinatori i Programit të Doktoraturës raportton rregullisht pranë Komisionit të përhershëm për dhënien e Gradës shkencore Doktor dhe merri miratimin e këtij Komisioni, lidhur me çdo haptë ndërmarrë prej tij. Ai shkarkohet nga funksioni i tij me votim, me shumicë të thjeshtë, nga anëtarët e Komisionit të përhershëm për dhënien e Gradës shkencore Doktor, bazuar në propozimin e Kryetarit, për shkelje sipas parashikimeve të Kodit të Etikës të UART ose shkeljetë tjera të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.


### **KREU III**

#### **Regjistrimi dhe Pranimi në Studimet e Doktoratës në Fakultetin e Arteve të Bukura, Njësia Bazë Pikturës**

##### **Neni 15**

#### **Njoftimi dhe Afatet në lidhje me pranimin në ciklin e tretë të studimeve**

1. Njoftimi për shpalljen e konkursit për regjistrim në Programin e Studimit të Doktoratës në Artet e Bukura shpallet me Urdhër të Rektorit të UART dhe publikohet në faqen eeb të UART sikurse dhe në vendet e përcaktuara për lajmërimë pranë Njesisë kryesore të FAB.
2. Njësia Bazë e Pikturës, në bashkërendim me Njësitë Bazë në FAB, duhet të përcaktojë kuotate pranimit, kriteret e përzgjedhjes, tarifën e konkurrimit, tarifën e regjistrimit në ciklin e tretë të studimeve dhe tarifën e shkollimit të aplikantëve për studime në ciklin e tretë të studimeve në Doktoraturë brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe tija përcjelli Dekanit të FAB për miratim paraprak. Dekani i FAB, kuotate e pranimit, kriteret e përzgjedhjes, tarifën e konkurrimit, tarifën e regjistrimit në ciklin e tretë të studimeve dhe tarifën e shkollimit, ia përcjell Senatit Akademik të UART për miratim.




3. Senati Akademik, pas miratimit paraprak të tarifës së regjistrimit dhe tarifës së shkollimit, në ciklin e tretë të studimeve, ia përcjell për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit të UART.
4. FAB ka detyrimin të bëjë publike kriteret e përcaktuara nga Njësia Bazë e Pikturës dhe në bashkëkordimin me Njësitë Bazë të FAB, për fushën e kërkimit shkencor që ofron. Këto kriteret nuk mund të ndryshohen deri në përfundim të procesit të pranimeve të reja.
5. Kriteret, procedurat dhe afatet për konkursin e pranimit në programin e studimit të doktoratës, publikohen në faqen zyrtare të UART, si dhe në ambientet e dukshme të FAB, të paktën një muaj përpara mbylljes së afatit për dorëzimin e kërkesave.
6. Njoftimi për shpalljen e konkursit, përveç të tjerave, duhet të përmbajë:
  - a. Kohëzgjatjen e programit të studimit të doktoratës.
  - b. Strukturimin dhe detyrimet, e ndërmjetme dhe përfundimtare, të punës kërkimore shkencore dhe veprimtarisë akademike.
  - c. Fushën e studimeve dhe projektin shkencor.
  - d. Afatin e pranimit të aplikimeve.
  - e. Tarifën e regjistrimit në konkursin e pranimit të studimeve.
  - f. Tarifën e studimeve në programin e doktoraturës.

## **Neni 16**

### **Regjistrimi në Konkursin e Pranimit**

1. Aplikimet në programin e studimeve të Doktoratës do të pranohen nga kandidatët që plotësojnë kriteret si më poshtë vijon:
  - a. Të zotërojnë një diplomë Bachelor dhe Master Shkencor/Master i Arteve, ose Diplomë të sistemit të vjetër 4 vjeçar/studime analoge jashtë vendit, në fushën ku ofrohet programi i studimit ose në fusha të ngjashme. Në rastin kur Diplomat e fituara (cikli i parë dhe cikli i dytë) janë dhënë nga një IAL jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duhet të jenë ekuivalentuar nga MAS konform ligjeve në fuqi. Për tu pranuar në programin e Doktoratës kandidatët kanë detyrimin që të zotërojnë diplomë të ciklit të parë dhe diplomë të ciklit të dytë, sipas përcaktimeve të këtij paragrafi, në fusha të ngjashme/të përafërta.
  - b. Kandidatët që zotërojnë diplomë, sipas përcaktimeve më sipër, në fusha të përafërta, vlerësohen bazuar në përputhshmërinë e lëndëve dhe programeve të Curriculës së tyre (Bachelor dhe Master) me ato të Curriculës së programit të njëjtë (Bachelor dhe Master) që paraprin programin e studimeve të Doktoratës.



Komisioni, bazuar në sa më sipër, mund të vlerësojë:

b.1.1. Vlefshmëri të plotë të programit, nëse lëndët, programet dhe kreditet (ECTS) e tyre janë të përafërta me ato të Curriculës (Bachelor dhe Master) të programit të njëjtë që paraprin studimet e doktoratës, në mbi 60% të tyre. Në rastin e vlerësimit pozitiv, Komisioni i Pranimi mund të sugjerojë lëndë të caktuara të cilat duhen ndjekur nga kandidati përpos detyrimeve të tjera programit të doktoraturës.

b.1.2. Njohje të pjesshme të programit studimor, nëse lëndët, programet dhe kreditet (ECTS) e tyre janë të përafërta me ato të Curriculës (Bachelor dhe Master) të programit të njëjtë që paraprin studimet e doktoraturës, në jo më pak se 50% të tyre. Në këtë rast kandidatët janë të detyruar të nënshtrohen testimit me shkrim dhe me gojë në disa prej lëndëve kryesore të programit (Bachelor dhe Master) që paraprin studimet e doktoraturës. Në rastin e vlerësimit pozitiv, Komisioni i Pranimi mund të sugjerojë lëndë të caktuara të cilat duhen ndjekur nga kandidati përpos detyrimeve të tjera të programit të doktoraturës.

b.1.3. Mosnjohje të programit të studimit, nëse lëndët, programet dhe kreditet (ECTS) e tyre janë të përafërta me ato të Curriculës (Bachelor dhe Master) të programit të njëjtë që paraprin studimet e doktoraturës, në më pak se 50% të tyre.

c. Prioritet merr kandidati që ka angazhim akademik pranë FAB, si staf akademik me kohë të plotë ose si staf akademik i ftuar.

d. Të dëshmojë njohuritë në një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), e vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

e. Në studimet e Doktoraturës do të pranohen vetëm kandidatët të cilët, në studimet Master i Arteve ose Master i Shkencave (ose në diplomën e sistemit 4 vjeçar) mesataren e ponderuar e kanë më të lartë ose të barabartë me 8.

2. Kandidati duhet të plotësojë dhe të paraqesë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për tu pranuar në konkurim sipas Shtojcës 1.

3. Të drejtën për tu regjistruar në Konkursin e pranimi për studimet e doktoratës e kanë edhe kandidatët me kombësi shqiptare që jetojnë jashtë kufirit të RSH sikurse dhe shtetasit e tjerë të huaj që plotësojnë kushtet e mësipërme (këta të fundit duhet të dëshmojnë, me dokumentacionin përkatës, njohjen e gjuhës shqipe konform ligjeve në fuqi).



## Neni 17


### Konkursi i Pranimit

1. Konkurrimi bëhet me dosje e cila duhet të përmbajë dokumentacionin sipas Shtojcës 1.
2. Vlerësimi maksimal i kandidatit është me 100 pikë. Minimumi i pikëve të grumbulluara për tu pranuar në programin e studimit të ciklit të tretë “Doktor” në Artet e Bukura është 40 pikë.
3. Kandidati dosjen për konkursin e ciklit të tretë të studimeve e dorëzon në Sekretarinë mësimore të FAB.
4. Sekretaria mësimore e FAB e regjistron aplikantin në regjistrin e posaçëm të regjistrimit për konkuset e pranimit në ciklin e tretë të studimeve dhe i lëshon kandidatit një formular ku vërtetohet marrja në dorëzim e dosjes. Ky formular plotësohet në dy kopje. Formulari është bashkëlidhur kësaj rregulloreje tek shtojcat.
5. Njësia Bazë e Pikturës, në bashkërendim me Njësitë Bazë në FAB ngre Komisionin e Pranimiti cili vlerëson me pikë elementët e dosjes së kandidatit. Dosja e kandidatit i dorëzohet Komisionit të pranimit nga Sekretaria mësimore e FAB.
6. Shpërndarja e pikëve për secilin nga elementët e dosjes përcaktohet nga Përgjegjësi i Njesisë Bazë të Pikturës në bashkërendim me Njësitë Bazë në FAB. Mbas vlerësimit të dosjeve të kandidatëve dhe renditjes së tyre me rend zbritës, Komisioni i Pranimit ia përcjell dosjen Dekaniti cili shpall fituesit dhe njofton Komisionin e përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor” me listën e kandidatëve fitues.
7. Lista e kandidatëve fitues shpallet edhe në faqen zyrtare të UART si dhe në vendin epërcaktuar nga FAB, gjithmonë duke respektuar kofidencialitetin e të dhënave të kandidatëve.

## Neni 18

### Kontrata e Doktorantit

1. Kandidatët fitues regjistrohen pranë sekretarisë së FAB sipas afateve kohore të shpallura.
2. Të gjithë kandidatët e shpallur fitues lidhin një kontratë me Njësinë Bazë të Pikturës pranë të cilës do të zhvillohet programi i doktoraturës, Udhëheqësin Artistik dhe Komisionin e përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor”, ku specifikohen detyrimet e secilës palë.
3. Për tu regjistruar në programin e studimit të doktoratës, veç të tjerash, kandidati për doktorant, Udhëheqësi Shkencor, apo sipas rastit Bashkudhëheqësi, duhet të paraqesin planin e punës i cili, pasi aprovohet nga Komisioni i Pranimit, formalisht, miratohet nga Komisioni i përhershëm për dhënien e Gradës “Doktor” dhe përfshihet në dosjen e kandidatit.



## **KREU IV**

### **Organizimi i Studimeve Dispozita të Përgjithshme**

Studimet e doktoraturës zhvillohen në përputhje me fushën e shpallur nga Njësia Bazë e Pikturës dhe organizohen në veprimtari kërkimore shkencore.

#### **Neni 19**


##### **Kohëzgjatja e studimeve të Doktoraturës**

1. Studimet e doktoraturës zhvillohen me kohë të plotë, pranë Njesisë Bazë të Pikturës, në bashkërendim me Njësitë Bazë në FAB dhe kanë një kohëzgjatje normale jo më pak se 3 (tre) vite akademike dhe jo më shumë se 5 (pesë) vite akademike.
2. Në rastet kur kandidati për doktorant është i punësuar si personel akademik, me kohë të plotë ose të pjesshme, pranë një tjetër institucioni të arsimit të lartë, apo si personel kërkimor në një institucion të kërkimit bazë ose të zbatuar, pranë institucioneve të arsimit të lartë të llojit Universitet ose Akademi, studimet mund të zhvillohen me kohë të zgjatur (5 vite akademike).
3. Në raste përjashtimore, me kërkesë të studentit, Komisioni mund të vendosë vetëm një herë për shtyrjen e studimeve të doktoratës, por jo më shumë se 2 (dy) vite në total. Arsyeja e shtyrjes së studimeve duhet të paraqitet e argumentuar nga kandidati.

#### **Neni 20**

##### **Pezullimi i përkohshëm i studimeve**

1. Kandidati, për arsye të përligjura, ka të drejtë të pezullojë, në periudha të caktuara, për jo më shumë se 2 (dy) vite, studimet e doktoratës.
2. Me pezullimin e studimeve, atij i pezullohen të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen me programin e tij të studimit. Këto i kthehen me rifillimin e studimeve.
3. Pezullimi i studimeve të doktoraturës së kandidatit kryhet me pëlqimin e udhëheqësit dhe, sipas rastit, bashkudhëheqësit të cilët shprehen me shkresë drejtuar Njesisë Bazë të Pikturës, pranë të cilës zhvillohet programi i doktoratës.
4. Kërkesa e kandidatit dhe mendimi i udhëheqësit dhe sipas rastit bashkudhëheqësit, i përcillet Komisionit të përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor”.
5. Pezullimi i përkohshëm i studimeve të doktoratës mund të kërkohet duke filluar nga viti i dytë



akademik dhe pasi të jenë shlyer të gjitha detyrimet e vitit të parë. Bëjnë përjashtim rastet kur kandidati kërkon të pezullojë studimet për arsye shëndetësore. Në raste të tilla kandidati nuk i nënshtrohet pikave 3, 4 të këtij Neni por është i detyruar ta vërtetojë kërkesën e tij me dokumentacionin lëshuar nga organet kompetente (raport mjekësor etj.).

6. Të gjitha arritjet dhe vlerësimet e kandidatit deri në momentin e pezullimit të studimeve merren parasysh. Në përfundim të studimeve ato përlllogariten në funksion të përmbushjes së detyrimeve për mbrojtjen e Temës së Doktoratës.

7. Pezullimi i studimeve të Doktoratës, përjashtuar rastet e dokumentuara për arsye shëndetësore, mund të kërkohej vetëm 1 (një) herë, ndërkohë që afati i pezullimit nuk përlllogaritet në afatet e kohëzgjatjes së studimeve të Doktoratës.

## **Neni 21**

### **Ndërprerja e studimeve dhe çregjistrimi nga programi i Doktoratës**

1. Kandidati për titullin shkencor “Doktor” mund të largohet nga UART, duke u çregjistruar përfundimisht. Për këtë ai bën një kërkesë me shkrim pranë Sekretarisë mësimore të FAB, në të cilën shpreh arsyet e largimit.
2. Çregjistrimi i kandidatit mund të kryhet vetëm pasi të jenë shlyer të gjitha detyrimet financiare të lindura deri në momentin e kërkesës për çregjistrim.
3. Dekani i FAB urdhëron çregjistrimin e kandidatit dhe vë në dijeni Njësinë Bazë të Pikturës, dhe Njësitë Bazë në FAB dhe Komisionin e përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.
4. Sekretaria Mësimore pasi kryen veprimet e çregjistrimit në regjistrin themeltar, ku vendos datën e çregjistrimit dhe nëse është e mundshme firmën e studentit, vë në dijeni Sektorin Mësimor dhe të Kurikulave, Sektorin e Statistikës dhe Drejtorinë Ekonomike për këtë akt.
5. Kandidati i çregjistruar ka të drejtë të tërheqë dokumentet e tij.

## **Neni 22**

### **Financimi i Studimeve**

1. Studimet e doktoratës, nuk financohen nga të ardhurat e Universitetit të Arteve.
2. Burimet Financiare për studimet e doktoraturës janë:
  - a. Tarifa e studimit të programit të doktoraturës.





- b. Tarifa e regjistrimit në Konkursin e Pranimin të Studimeve në programin e doktoraturës.
- c. Fonde të siguruara nga institucione shtetërore ose organizata të ndryshme, për projektet kërkimore të studimeve të doktoraturës.
- d. Fonde të siguruara nga institucione shtetërore ose organizata të ndryshme për kërkimin shkencor dhe/ose veprimtaritë krijuese.
- e. Fonde të siguruara, nga vetë doktorantët, pranë institucioneve shtetërore ose organizatave të ndryshme.
- f. Vetëfinancim i doktorantit.
- g. Të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta
- h. Donacione dhe burime të tjera të ligjshme të financimit.

3. Tarifa e studimeve të doktoratës paguhet me këste si më poshtë vijon:

- a) Kësti i parë i tarifës së studimeve të doktoratës (25% e shumës) paguhet në përfundim të semestrit I;
- b) Kësti i dytë i tarifës së studimeve të doktoratës (25% e shumës) paguhet në përfundim të semestrit III nga nisja e studimeve të doktoratës;
- c) Kësti i tretë dhe i fundit i tarifës së studimeve të doktoratës (50% e shumës), paguhet në përfundim të semestrit V, por në çdo rast më parë se paraqitja e kërkesës për Mbrojtjen e Temës së Doktoratës.

4. Në rast të pezullimit të studimeve të Doktoratës, të gjitha këstet e pagesave të bëra nga studenti Doktorant do të njihen.


5. Në rastin e çregjistrimit/ humbjes së statusit të studentit në studimet e Doktoratës, të gjitha këstet e pagesave të bëra nga studenti Doktorant deri në atë moment, janë të pakthyeshme.

6. Afatet e pagesës së tarifës së studimeve, sipas përcaktimeve të mësipërme, pasqyrohen në kontratën e doktorantit.

### **Neni 23**

#### **Zhvillimi i studimeve të Doktoratës**

- 1. Studimet e doktoratës zhvillohen bazuar në Programin e Kërkimit Shkencor.
- 2. Programi i Kërkimit Shkencor zhvillohet nën drejtimin e Udhëheqësit Shkencor, në përputhje me planin e punës, fushën dhe projektin kërkimor. Fusha dhe projektet kërkimore përcaktohen nga Njësia Bazë e Pikturës në bashkërendim me Njësitë Bazë në FAB, pranë të cilës zhvillohet



programi i doktoratës, dhe publikohen së bashku me shpalljen e konkursit të doktoratës.

3. Programi i Kërkimi Shkencor strukturohet në:

a) Përmbajtjen Shkencore, e cila përfshin të gjithë veprimtarinë shkencore të kandidatit gjatë programit të doktoratës (konferenca, referate, publikime të ndryshme në revistaetj.);

b) Tema e Dizertacionit.

4. Ecuria e punës shkencore të kandidatit do të vlerësohet çdo vit akademik, në përputhje me planin e punës së aprovuar, nga Komisioni i Vlerësimeve të Pjesshme.

5. Në përfundim të vitit të parë akademik, kandidati paraqet projektin kërkimor të detajuar përpara Komisionit të Vlerësimeve të Pjesshme. Në paraqitjen e detajuar të projektit kërkimor kandidati përqendrohet në

a. Trajtimin e temës së kërkimit shkencor.

b. Bibliografinë e përzgjedhur dhe paraqitjen e disa rasteve konkrete në lidhje me temën e kërkimit shkencor.

c. Metodologjinë.

6. Në përfundim të çdo viti pasardhës akademik (viti II e në vazhdim) kandidati duhet të referojë përpara Komisionit të Vlerësimeve të Pjesshme, rreth punimeve të kryera dhe ecurisë së punës kërkimore. Në referimet e pjeshme kandidati përqendrohet në:

a. Adresimin e problematikave të verifikuara nga Komisioni i Vlerësimeve të Pjesshme (nëse ka).

b. Ecurinë dhe rezultatet e punës kërkimore mbas referimit paraardhës.


7. Në përfundim të çdo viti akademik, kandidati duhet të raportojë tek Koordinatori i Doktoratës rreth realizimit të Përmbajtjes Shkencore, sikurse dhe të dorëzojë dokumentacionin që vërteton realizimin e veprimtarive të Përmbajtjes Shkencore. Si rregull veprimtaritë e Përmbajtjes Shkencore duhet të shtrihen përgjatë të gjitha viteve të studimeve të doktoratës.

8. Përpara paraqitjes së kërkesës për mbrojtjen e Temës së Doktoratës, kandidati duhet:

a. Të ketë realizuar si autor i parë ose i dytë, kur autori i parë është udhëheqësi shkencor, së paku 3 (tre) referime, 2 (dy) nga të cilat të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD-së ose G20-s, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.

b. Të ketë botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore nga të cilët 1 (një) të jetë botuar ose pranuar për botim në revista shkencore të rankuara në Journal Citation Reports ose Scopus, ku, së paku, të jetë autor i dytë.

c. Të ketë paraqitur pjesë të punës kërkimore në të paktën 3 takime në kuadër të Forumit



të Doktoraturës.

d. Të jetë vlerësuar pozitivisht nga KVP. e. Të ketë shlyer të gjitha detyrimet financiare sipas kontratës së lidhur.

#### **Neni 24**

#### **Forumi i Doktoratës**

1. Forumi i Doktoraturës është një aktivitet i përvitshëm i mbajtur në kuadër të studimeve të doktoratës dhe i organizuar nga Komisioni i përhershëm për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.
2. Ai përbën një forum të hapur ku, kandidatët për doktorantë, trajtojnë dhe debatojnë me njëri-tjetrin tema të ndryshme sipas programeve të tyre kërkimore.
3. Forumi i Doktoratës organizohet nga Koordinatori i studimeve të Doktoratës dhe monitorohet nga Komisioni i përhershëm për dhënien e Gradës Doktor.
4. Rektori i UART, për çdo vit akademik, cakton një prej Koordinatorëve të programeve të doktoratës pranë Njësive Bazë, për të drejtuar dhe organizuar takimet e Forumit të Doktoratës.
5. Kandidati për gradën “Doktor” duhet të marrë pjesë të paktën 3 herë në Forumin e doktoraturës sipas afateve të përcaktuara prej tij dhe Udhëheqësit Shkencor.

#### **Neni 25**

#### **Ndryshimi dhe/ose Modifikimi i Temës së Doktoratës**

1. Kandidati ka të drejtën të ndryshojë dhe/ose modifikojë Temën e Doktoratës.
2. Ndryshimi dhe/ose modifikimi i temës së doktoratës së kandidatit kryhet me pëlqimin e Udhëheqësit Shkencor dhe, për rastet kur aplikohet, të Bashkudhëheqësit, të cilët shprehen me shkresë drejtuar Njesisë Bazë të Pikturës pranë të cilës zhvillohet programi i doktoratës.
3. Përgjegjësi i Njesisë Bazë i Pikturës, brenda 5 ditësh, i përcjell kërkesën Komisionit të Vlerësimeve të Pjesëme i cili, brenda 5 ditësh, jep vendimin e tij.
4. E drejta për ndryshimin dhe/ose modifikimin e Temës së Doktoratës mund të ushtrohet vetëm një herë dhe jo më vonë se përfundimi i Semestrit të parë të vitit I-rë akademik referuar fillimit të studimeve të doktoraturës së kandidatit.

#### **Neni 26**

#### **Doktoraturat Ndërinstitucionale**

1. UART gëzon të drejtën e organizimit të studimeve të doktoraturës në bashkëpunim me IAL dhe Qendra Kërkimore të tjera brenda dhe jashtë vendit.




2. Në rastet e doktoraturave të përbashkëta, mes institucioneve nënshkruhet një marrëveshje bashkëpunimi ku përcaktohen detyrimet e secilës palë dhe institucioni përgjegjës për monitorimin e studimeve.
3. Marrëveshja e nënshkruar, përveç të tjerave, duhet të marrë parasysh:
  - a. Përcaktimin e institucionit përgjegjës për monitorimin e studimeve të doktoraturës.
  - b. Përcaktimin e institucionit përgjegjës si partneri kryesor në nënshkrimin e diplomës “Doktor” sipas emërimit përkatës.
  - c. Caktimin e dy udhëheqësve.
  - d. Njohjen reciproke të gradës shkencore “Doktor” sipas emërimit përkatës.
  - e. Gjyken e hartimit të Temës së Dizertacionit.
4. Në rastet e parashikuara sipas përcaktimeve të Nenit 11 (Bashkudhëheqësi), një nga udhëheqësit, mund të përmbushë edhe detyrat e Bashkudhëheqësit Akademik.
5. Në përfundim të studimeve të doktoratës ndërinstitucionale, diploma shkencore “Doktor“, në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar, lëshohet si diplomë e përbashkët, e dyfishtë ose e shumëfishtë dhe nënshkruhet nga të dy institucionet partnere.
6. Programet e doktoratave ndërinstitucionale mund të parashikojnë rregulla të tjera dhe/ose të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë rregullore.

## Neni 27

### Transferimi i studimeve të doktoratës

1. Fakulteti i Artit Skenik, Njësia Bazë Pikturës pranon transferimin e kandidatëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” në Artet e Bukura IAL të tjera, brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me kuotat e paracaktuara nga fakulteti dhe të miratuara nga Senati Akademik dhe ministria e linjës.
2. Transferimi i kandidatit do të merret në konsideratë vetëm në rastet kur fusha e punës kërkimore dhe projekti i doktoratës është i njëjtë ose i ngjashëm me ato të programit të doktoratës pranë Njesisë Bazë Pikturës.
3. Kandidati që kërkon të transferojë studimet e doktoratës pranë Njesisë Bazë Pikturës, Fakulteti i Arteve të Bukura, duhet të plotësojë të gjitha kriteret hyrëse sipas përcaktimeve të Nenit 16 të kësaj Rregulloreje.
4. Financimi i studimeve të doktoratës, për kandidatët që kërkojnë të transferojnë studimet e doktoratës pranë Njesisë Bazë Pikturës, Fakulteti i Arteve të Bukura, kryhet në përputhje me



përcaktimet e kësaj Rregulloreje.

## **Neni 28**

### **Procedura e transferimit të studimeve të doctorates**

1. Kandidati që kërkon të transferojë studimet e doktoratës pranë Njesisë Bazë Pikturës, Fakulteti i Arteve të Bukura, paraqet pranë Sekretarisë së FAB kërkesën me shkrim për transferimin e studimeve shoqëruar me dokumentacionin sipas Shtojcës 1.
2. Dosja e kandidatit, përveç dokumentacionit të përcaktuar në Shtojcën 1, duhet të përmbajë edhe arritjet e punës kërkimore, në kuadër të studimeve për fitimin e gradës shkencore “Doktor”, deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për transferim studimesh.
3. Sekretaria mësimore e FAB e regjistron kandidatin në regjistrin e posaçëm të regjistrimit për konkurset e transferimit në ciklin e tretë të studimeve dhe i lëshon kandidatit një formular ku vërtetohet marrja në dorëzim e dosjes. Ky formular plotësohet në dy kopje. Formulari është bashkëlidhur kësaj rregulloreje tek shtojcat.
4. Njësia Bazë e Pikturësë ngre komisionin ad hoc i cili vlerëson me pikë elementët e dosjes së kandidatit. Dosja e kandidatit i dorëzohet Komisionit të Pranimi nga Sekretaria mësimore e Fakultetit të Arteve të Bukura.
5. Vlerësimi i dosjes së kandidatit, për transferim të studimeve të doktoratës, bëhet në përputhje me parashikimet e kësaj rregulloreje.
6. Komisioni ad hoc, vlerëson punën kërkimore të kryer nga kandidati deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për transferim dhe vendos pranimin ose jo të kandidatit sipas kuptimit të kësaj rregulloreje.
7. Kandidati fitues nënshkruan kontratën e Doktorantit sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.
8. Kandidati ka të drejtë të ankimojë vendimin e Komisionit ad hoc sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje.
9. Në rastet kur kandidati për fitimin e gradës shkencore “Doktor”, pranë Njesisë Bazë Pikturës, kërkon të transferojë studimet në një IAL tjetër, ai paraqet kërkesën me shkrim, për transferimin e studimeve, tek drejtuesi i Njesisë Kryesore i cili ia përcjell për vlerësim Njesisë Bazë.
10. Kërkesa e kandidatit për transferim në një IAL tjetër merret në konsideratë vetëm në rastet kur ai ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj Njesisë Bazë Pikturës, Fakulteti i Arteve të Bukura dhe Universitetit të Arteve Tiranë.



## Kreu V

### Tema e Dizertacionit dhe Mbrojtja Dispozita të Përgjithshme

Pranimi në mbrojtjen e temës së dizertacionit, nis sapo kandidati paraqet kërkesën dhe dokumentacionin e nevojshëm për të filluar procedurën e mbrojtjes së temës së dizertacionit.


#### Neni 29

##### Dizertacioni

1. Tema e dizertacionit konsiston në një punim shkencor origjinal.
2. Dizertacioni duhet të respektojë kërkesat e paraqitjes sipas këtij neni. Nëse dizertacioni nuk paraqitet sipas këtyre kërkesave, ai nuk pranohet deri sa të plotësohen të gjitha kërkesat e formatit.
3. Në rastin e doktoratuave ndërinstitucionale, sipas përcaktimeve të Kreut IV, Neni 26, mund të aplikohen standarte të ndryshme të paraqitjes së dizertacionit të cilat duhet të jenë përcaktuar në marrëveshje mes palëve partnere.
4. Të paktën 5 (pesë) kopje të Dizertacionit duhet të dorëzohen në origjinal.



5. Dizertacioni ka një shtrirje rreth 200-250 faqe (pa llogaritur figura, citime, shembuj letrarë apo dramaturgjikë/fimikë ose jo dhe tabela me numëruesin e tyre). Ai formatohet si më poshtë vijon:
- a. Kopertina formatohet sipas Shtojcës 2 ku lart në qendër duhet të vendoset logoja e UART dhe FAB. Në qendër më poshtë vendoset emërtimi i programit. Në mes të faqes, në qendër vendoset titulli i plotë i temës, emri i kandidatit, emri i Udhëheqësit dhe, kur ka, Bashkudhëheqësit dhe viti i mbrojtjes;
  - b. Faqja e parë duhet të përmbajë: Përmbledhjen e temës (abstraktin) në shqip dhe në anglisht. Secili nga variantet duhet të shtjellohet në jo më shumë se 200 fjalë në Times New Roman 10,
  - c. Fushën dhe fjalët kyçe në shqip dhe në anglisht:
  - d. Dizertacioni duhet të shtypet në letër të bardhë të cilësisë së lartë në format A4 dhe të lidhet; e. Materiali shtypet vetëm nga njëra anë e letrës. Dorëshkrimet nuk pranohen;
  - f. Teksti duhet të shtypet në Times New Roman 12, me hapësirë 1.5 mes rreshtave. Tabelat e gjata shtypen në hapësirë 1. Shënimet, citimet dhe bibliografia shkruhen në Times New Roman 10;
  - g. Hapësirat (margjinat) duhet të jenë:
    - g.1. Hapësira e sipërme 1”
    - g.2. Hapësira e poshtme 1”
    - g.3. Hapësira e djathtë 1.25”
    - g.4. Hapësira e majtë 1.25”
  - h. Numrat e faqeve vendosen poshtë dhe në qendër të faqes;
    - i. Parathënia shkruhet me shkronja kursive; Hyrja numërohet me shifra romake ndërsa pjesa tjetër e punimit me numra arabë. Faqet e bibliografisë dhe shtojcave të ndryshme numërtohen me numra arabë në vijim të tekstit;
  - j. Shënimet (footnote) duhen vendosur në fund të faqes përkatëse dhe jo në fund të punimit.
  - k. Tabelat numërtohen (me numra arabë) dhe vendosen në trup të punimit e jo në fund. Fjala “Tabelë”, numri i Tabelës dhe legjenda e saj vendosen në krye të Tabelës. Kur Tabela vazhdon në faqen tjetër legjenda nuk përsëritet. Nëse Tabela përmban citate, duhen shënuar referencat;
  - l. Kur punimi përmban diagrame dhe figura, ato duhen vendosur në faqen përkatëse. Ato



numërtohen me numra arabë dhe shpjegimet vendosen poshtë tyre. Nëse një diagramë kalon në faqen pasardhëse ndiqet rregulli i përcaktuar për Tabelat;

- m. Ku punimi përmban materiale shoqëruese (CD, video etj.) që janë pjesë e rëndësishme e punimit, ato i bashkëngjiten atij dhe shënohen te Tryeza e lëndës që vendoset në fillim të punimit;
- n. Bibliografia e plotë vendoset në fund të punimit.
- o. Përdorimi i ideve apo edhe i një pjese të punës së të tjerëve duhet të evidentohet në tekst duke bërë shënimin në listën e referencave ose në bibliografi.
- p. Për të gjitha citimet nga burimet e të tjerëve duhet të shënohet qartë burimi.
- q. Sqarimet e mundshme të kandidatit duhet të futen në kllapa katrore.
- r. Nëse burimi origjinal mungon por ai është gjendur në një burim të dytë, atëherë duhet të citohet edhe burimi i parë edhe burimi i dytë.

### Neni 30

#### Pranimi në Mbrojtjen e Doktoraturës

1. Për tu pranuar në Mbrojtjen e Temës së Doktoratës, kandidati dorëzon pranë Dekanit të FAB:
  - a) Temën e Dizertacionit të përfunduar (në pesë kopje). Faqe 23
  - b) Një përmbledhje të dizertacionit (në tre kopje) me rreth 2000-4000 fjalë në gjuhën shqipe dhe në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Europian (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht dhe spanjisht).
  - c) Dosjen shoqëruese e cila duhet të përmbajë :
  - d) Dokumentacionin që vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve.
  - e) 2 (dy) CD me përmbajtjen e plotë në formatin PDF dhe word.
  - f) Autoreferat në 10 kopje i cili u shpërndahet anëtarëve të jurisë dhe personave të pranishëm në mbrojtjen publike të temës së doktoraturës.
  - g) Kërkesë me shkrim për caktimin e datës së mbrojtjes së doktoraturës.
  - h) Deklaratë e Kandidatit rreth punës kërkimore realizuar vetëm gjatë kohëzgjatjes së studimeve të doktoraturës.
  - i) Deklaratë e Kandidatit mbi origjinalitetin e Temës së Dizertacionit.
  - j) Deklarata e aprovimit të Udhëheqësit Shkencor dhe, në rastet kur ka, Bashkudhëheqësit;
2. Kërkesa për mbrojtjen e diplomës paraqitet brenda 5 (pesë) ditëve nga data e mbylljes së semestrit të fundit të programit të studimeve.
3. Kërkesa paraqitet të paktën 5 (pesë) semestra mbas fillimit të studimeve të doktoratës.





4. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga data e dorëzimit, Dekani përcjell të gjithë dokumentacionin, e dorëzuar nga kandidati, tek Njësia Bazë e Pikturës pranë të cilës zhvillohet programi i doktoratës.

5. Njësia Bazë e Pikturës, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e përcjelljes së dokumentacionit nga Dekani i Fakultetit, ngre komisionin ad hoc të vlerësimit të temës së doktoratës së kandidati.

6. Komisioni ad hoc i vlerësimit të temës së doktoratës përbëhet nga 3 anëtarë të cilët kanë të paktën gradën shkencore “Doktor” të fituar në vendet e OECD ose i përkasin kategorisë “Profesor”. Prioritet për të qenë anëtarë të këtij komisioni kanë anëtarët e Komisioneve të Vlerësimeve të Pjesëtimeve të doktorantit

7. Komisioni brenda 15 ditëve nga ngritja e tij, jep vlerësimin për temën e doktoratës dhe ia përcjell Komisionit për dhënien e gradës Doktor.

7.1. Nëse Komisioni i vlerësimit të temës së doktoratës jep vlerësim negativ, kandidati ka të drejtë të ri paraqesë disertacionin dhe/ose dosjen të plotësuar pas një periudhe jo më të shkurtërse 3 (tre) muaj.

8. Dizertacioni dhe dosja e vlerësuar pozitivisht nga komisioni i vlerësimit, brenda 5 (pesë) ditëve, i përcillet Komisionit të përhershëm për dhënien e Gradës “Doktor”.

9. Komisioni i përhershëm për dhënien e Gradës “Doktor”, bazuar në vlerësimin e komisionit ad hoc për vlerësimin e dizertacionit dhe dosjes së kandidati, gjykon nëse duhet të procedojë me ngritjen e Jurisë së Mbrojtjes ose jo. Në rastin kur Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Doktor shkencore “Doktor” jep vlerësim negativ, dosja i kthehet Njesisë Bazë shoqëruar me argumentet e vlerësimit. Njësia Bazë e Pikturës, brenda 5 (pesë) ditëve, ia përcjell dosjen komisionit ad hoc për vlerësimin e temës së Faqe 24 doktoraturës për ta rishqyrtuar. Komisioni ad hoc jep gjykimin përfundimtar dhe brenda 10 (dhjetë) ditëve dosja i rikthehet Komisionit për dhënien e gradës shkencore “Doktor”.

10. Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Doktor shkencore “Doktor” brenda 30 (tridhjetë) ditëve, bazuar në propozimet e Njesisë Bazë të Pikturës në bashkërendim me Njësitet Bazë në FAB, pranë të cilës zhvillohet programi i doktoratës, dhe miratimin e Dekanit të Fakultetit, ngre Jurinë e Mbrojtjes së temës së dizertacionit.

11. Juria e Mbrojtjes brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga formimi i saj, përcjell datën e mbrojtjes së doktoraturës e cila nuk mund të jetë më herët se 3 (tre) muaj nga data e formimit të Jurisë.



### Neni 31

#### Etika e punës kërkimore

1. Kur dorëzon tezën e përfunduar studenti duhet të deklarojë me shkrim se studimi është punë origjinale e tij.
2. Kandidati nuk lejohet të paraqesë si punim të ri një temë të nisur më herët që e ka paraqitur ose nisur në kuadër të studimeve të doktoratës në një institucion tjetër. Doktoranti mund të paraqesë pjesë të punës së tij, duke treguar qartë se cila pjesë e punës është përdorur edhe më parë.
3. Plagjiatura përfshin përdorimin e ideve dhe të fjalëve nga publikimet e një personi tjetër pa dhënë referencën përkatëse. Duhet të shënohet referenca përkatëse nëse përdoren ide të tjerëve.
4. Kandidati duhet të sqarohet nga Udhëheqësi i tij që në fillim të punës, për rrezikun dhe pasojat në rastet e konstatimit të mashtrimit, falsifikimit dhe të plagjiaturës.

### Neni 32

#### Mbrojtja e Temës dhe Fitimi i Titullit Shkencor “Doktor”

1. Mbrojtja kryhet e hapur për publikun me përjashtim të rasteve kur, për arsye të veçanta (të dhëna konfidenciale, sekret profesional etj.), me vendim të Dekanit zhvillohet vetëm në prani të Jurisë.
2. Në rastet kur, për arsye të përligjura, anëtarë të Jurisë, nuk mund të jenë të pranishëm në datë shpallur, mbrojtja e temës së dizertacionit shtyhet dhe Juria cakton një datë tjetër. Ricaktimi i datës së mbrojtjes, për shkak të pamundësisë së pjesëmarrjes së një prej Faqe 25 anëtarëve të Jurisë, përveç Udhëheqësit, mund të bëhet vetëm një herë. Në të gjitha rastet e tjera veprohet sipas përcaktimeve të Pikës 3 të këtij Neni.
3. Nëse ndonjë prej anëtarëve të Jurisë tërhiqet nga pjesëmarrja, ose kërkon shtyrjen e datës së mbrojtjes për më shumë se një herë, Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Doktor shkencore “Doktor” cakton, prej anëtarëve të propozuar nga Njësia Bazë e Pikturës, në bashkërendim me Njësitë Bazë në FAB dhe të miratuar nga Dekani, një tjetër anëtar.
4. Për arsye të përligjura, kandidati ka të drejtën të kërkojë shtyrjen e datës së mbrojtjes dhe caktimin e një date tjetër.
5. Kandidati ka detyrimin që për secilin anëtarë të Jurisë të sigurojë:
  - a) një kopje të dizertacionit të shtypur;
  - b) një përmbledhje të dizertacionit, në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Europian (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht ose spanjisht) të shtypur;



c) një kopje (CD ose USB) me materiale, nëse ka, shtesë mbështetëse të temës së dizertacionit (materiale audio, video etj.).

6. Mbrojtja e temës së dizertacionit nga pikëpamja procedurale duhet të përmbajë;

a. Paraqitjen nga Kryetari i jurisë të vendimit të ngritjes së këtij komisioni, të plotësimin të dokumentacionit të dosjes, të përbërjes së jurisë dhe deklarimit nga ana e tij për hapjen e procedurës së mbrojtjes.

b. Paraqitjen e dizertacionit nga studenti për një kohë prej 25-30 minuta.

c. Paraqitjen e oponencave. Në fillin fjalën e merr oponenti/ja e jashtme dhe më pas oponenti/jae brendshme. Oponentët japin vlerësimin me shkrim të dizertacionit të firmosur në secilën faqe prej tyre, ku saktësohet nëse punimi në tërësi përmbush kërkesat e paraqitura në programin e doktoratës, duke iu kushtuar vëmendje vlerave origjinale, që paraqet punimi, si dhe duke vënë në dukje anët pozitive dhe negative të tij (nëse ka të tilla).

d. Oponentët në fund të leximit të tyre ia dorëzojnë materialin e shtypur dhe të firmosur Kryetarit të komisionit të vlerësimin të cilat bëhen pjesë e dosjes së vlerësimin të kandidatit.

e. Pyetje të anëtarëve të komisionit të vlerësimin rreth disertacionit dhe oponencave, drejtuar studentit doktorant.

f. Kandidati i mban shënim të gjitha pyetjet e bëra nga anëtarët e komisionit të vlerësimin dhe pasi konsultohet edhe me Udhëheqësin e tij shkencor, kthen përgjigje për secilën prej tyre.

g. Diskutime nga Juria.

h. Në fund pas diskutimeve të anëtarëve të jurisë kandidati nëse kërkohet mund të japë sqarime të mundshme.

i. Në fund i jepet fjala Udhëheqësit të doktorantit nëse dëshiron të shprehet rreth punës kërkimore shkencore.

j. Kryetari i jurisë kërkon tërheqjen e komisionit për vlerësimin e kandidatit.

k. Kryetari i jurisë u shpërndan fletëvotimet e firmosura prej tij, anëtarëve të jurisë dhe i fton në votim të fshehtë për vlerësimin e doktorantit.

l. Në prani të gjithë anëtarëve të komisionit hapen fletët e votimit dhe kryetari mbledh pikët e vëna dhe i pjesëton me pesë.

m. Vlerësimi përfundimtar pasqyrohet në procesverbalin e rezultatit të votimit dhe shpalljen e vendimit me shkrim.

7. Vlerësimi i mbrojtjes së temës së doktoraturës së kandidatit bëhet 0-100 pikë. Vlerësimi përfundimtar në përqindje në raport me totalin e pikëve të siguruara është si më poshtë vijon:

**100% - 80% = shumë mirë**

**79% - 65% = mirë**



**64% - 50% = mjaftueshëm**

**49% e më pak = pakalueshëm**

8. Tema e doktoraturës vlerësohet me notë si më poshtë:

**Nota 9 – Nota 10 = shumë mirë**

**Nota 7 – Nota 8 = mirë**

**Nota 5 – Nota 6 = mjaftueshëm**

**Nota 4 = pakalueshëm**

9. Në përfundim të të gjithë procedurës së mbrojtjes së doktoraturës, Juria harton raportin e vlerësimit dhe ia përçjell Komisionit të përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor”.

10. Në rastet kur vlerësimi i Jurisë është 50% e më shumë e pikëve totale të mundshme, Komisioni i përhershëm për dhënien e Gradës shkencore “Doktor”, brenda 10 (dhjetë) ditëve, merr vendimin për dhënien e gradës shkencore "Doktor" sipas emërimit përkatës dhe ia përçjell Dekanit.

11. Dosja e kandidatit, përfshirë tezën e dizertacionit, vlerësimin e Jurisë dhe vendimin e Komisionit të përhershëm për Dhënien e Gradës shkencore “Doktor” i përcillet Rektorit të Universitetit të Arteve.

12. Diploma për Gradën “Doktor” nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori i Universitetit të Arteve. Një kopje dërgohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve për t’u pasqyruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë.

13. Kandidati, dizertacioni i të cilit konsiderohet pakalueshëm, ka të drejtë të riparaqesë, pranë Komisionit të përhershëm për dhënien e Gradës “Doktor”, temën e doktoraturës së rishikuar me një afat kohor jo më herët se 6 (gjashtë) muaj dhe jo më vonë se 1 (një) vit nga vlerësimi i Jurisë. Paraqitja e temës së dizertacionit mund të përsëritet vetëm një herë. Faqe 27

14. Për të gjitha rastet e parashikuara në pikën 13 të këtij Neni, Juria brenda 15 ditësh nga data e ri dorëzimit të temës së dizertacionit, ri cakton datën e mbrojtjes e cila nuk mund të jetë më vonë se 3 (tre) muaj nga data e ri dorëzimit të temës.

15. Nëse edhe në mbrojtjen e dytë kandidati merr vlerësimin 49% e më pak të pikëve totale, Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Doktor shkencore “Doktor” merr vendimin për çregjistrimin e kandidatit nga programi doktoratës dhe vë në dijeni Njësinë Bazë të Pikturës, si dhe Njësitë Bazë në FAB pranë të cilës zhvillohet programi i doktoraturës, dhe Dekanin e FAB.



16. Kohëzgjatja e procedurave të mbrojtjes apo rimbrotjes së temës së doktoratës, nuk llogariten brenda kohëzgjatjes (normale apo maksimale) të studimeve të doktoratës.

### **Neni 33**

#### **Publikimi i Temës së Dizertacionit**

1. Doktoranti ka të drejtën e publikimit të Temës së Dizertacionit vetëm mbas vlerësimit përfundimtar pozitiv të Jurisë.
2. Doktoranti ka për detyrim që një kopje të temës së Dizertacionit duhet ta dorëzojë në Bibliotekën e Universitetit të Arteve dhe një kopje në Bibliotekën Kombëtare. Fletën e dorëzimit të kopjeve të dizertacionit e dorëzon pranë sekretarisë së FAB. Në rast të mos dorëzimit të këtyre fletëve nuk pajiset me diplomë.

### **Neni 34**


#### **Revokimi/anulimi i Gradës Doktor**

1. Nëse pas mbrojtjes së dizertacionit ka të dhëna të besueshme, konstatohet apo vërtetohet se grada shkencore "Doktor" është fituar në shkelje të rregullave të etikës mbi kërkimin shkencor, ose kur mbrojtja është bërë në kundërshtim me kuadrin ligjor, fillon procedura për anulimin e kësaj grade. Procedurat e këtij anulimi përcaktohen nga njësia kryesore.
2. Personi ndaj të cilit fillon procesi i shqyrtimit të gradës, duhet të njoftohet në lidhje me shkakun, procedurat që do të ndiqen dhe mbi të drejtën që ka për t'u mbrojtur, në përputhje me Kodin e procedurave Administrative.

### **Neni 35**

#### **Apelimi**

1. Kandidatët të cilët nuk fitojnë të drejtën për tu regjistruar në programin e studimit të doktoraturës, kanë të drejtën që, brenda 5 ditësh pune nga shpallja e rezultatit, të paraqesin ankimimin e tyre me shkrim pranë Dekanit të Fakultetit. Dekani, brenda 3 ditësh pune nga dorëzimi i ankimimit, i kërkon Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" të marrë në shqyrtim vlerësimin dhe procedurën e ndjekur nga Komisioni i Pranimit. Komisioni i Përhershëm për dhënien e Gradës Shkencore "Doktor", pasi konsultohet me



Komisionin e Pranimit, brenda 6 ditësh pune nga depozitimi i ankimit nga ana e Dekanit në këtë komision (KPDHGD), vendos:

a) Rishqyrtimin e aplikimit të kandidatit për doktorant.

b) Lënien në fuqi të vlerësimit të Komisionit të Pranimit. Vendimi i Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” është i formës së prerë dhe i paapelueshëm.

2. Pas vendimit të Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, riorganizohet renditja e kandidatëve sipas pikëve të siguruara.

3. Në rastet kur Komisioni i Vlerësimeve të Pjeshme merr vendime sipas përcaktimeve në Neni 7, Pika 6, doktoranti ka të drejtë, që brenda 2 ditësh nga vlerësimi, ti drejtohet me shkresë Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës “Doktor” i cili pasi kërkon sqarime nga Komisioni i Vlerësimeve të Pjesslune, Udhëheqësi Shkencor dhe doktoranti jep vendimin e tij i cili është i paapelueshëm.

4. Në rastet kur komisioni ad hoc i vlerësimit të temës së doktoraturës jep vlerësim negativ, doktoranti, brenda 2 ditësh, mund ti drejtohet Komisionit të Përhershëm për dhënien e gradës “Doktor” me shkresë për të apeluar vendimin. Komisioni i Përhershëm për dhënien e Gradës “Doktor” pasi ka vlerësuar procedurën e ndjekur dhe, sipas rastit, ka marrë sqarimet e nevojshme nga komisioni ad hoc, brenda 5 ditësh, mund të vendosë aprovimin e vendimit të komisionit ose rivlerësimin e temës së doktoratës. Në rastet kur dekani vendos rivlerësimin e temës së doktoraturës, komisioni ad hoc i vlerësimit të temës duhet të ndryshohet me 2/3 e anëtarëve të tij.

5. Doktoranti ka të drejtën e apelimt të vendimit të Jurisë. Me këtë rast, ai mund ti drejtohet me shkresë Komisionit të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, jo më vonë se 10 ditë nga data e mbrojtjes së Temës së Doktoratës. Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, pas marrjes së kërkesës së ankimit, thërret në një seancë shqyrtimi Jurinë dhe Udhëheqësin Shkencor të Doktorantit. Pas kësaj seance, Komisioni i Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” shpall gjykimin e tij, i cili është i paapelueshëm. Thirrja e seancës shqyrtuese dhe marrja e vendimit nuk duhet të jetë më shumë se 30 ditë nga data e marrjes së ankimit.

## KREU VI

### **Të Drejtat dhe Detyrimet e Kandidatëve për Gradën Doktor Neni 36**

#### **Fitimi, pezullimi dhe humbja e statusit të Doktorantit**



Programi studimit do të përdori infrastrukturën mësimore e laboratorike që është në Fakultetin e Arteve të Bukura të UART. Këto krahas klasave përfshihen edhe ateljet, laboratorë, si dhe galeria. Infrastruktura në shërbim të programit do të jetë:

Fakulteti i Arteve të Bukura ndodhet me seli në adresën Bulevardi dëshmorët, Sheshi “Nënë Tereza”, dhe disponon 1 godina me emërtimin “E”. Kjo godinë është ndërtuar në vitin 2007, ndërtesë e cila posedon një sipërfaqe të shfrytëzuar prej 2475 m<sup>2</sup>, ka në dispozicion Galerinë e Arteve me një sipërfaqe prej 384 m<sup>2</sup>. FAB posedon një sipërfaqe ekspozimi prej 296 m<sup>2</sup> dhe e gjithë sipërfaqja e disponueshme në funksion të mësimdhënies dhe veprimtarive artistike – shkencore është 2475 + 500 m<sup>2</sup> (biblioteka). FAB posedon 28 mjedise gjithsej, ku nga këto janë 2 audltoqe që shërbejnë për lektorium dhe 1 sallë pedagogësh.

Sallat për leksionet dhe seminarët janë të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni. Laboratorët sipas profileve artistike, ateljerët dhe klasat janë pajisur me softëaret përkatës në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mirë programit mësimor.

Ambientet universitare janë të mbuluara me sinjal ËiFi në mënyrë që studentët të aksesojnë lirisht ëëbin. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike dhe materiale artistike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit pranë UART. Instalimet e programeve dhe azhurnimet e tyre bëhen në kohë reale.

Në të njëjtën kohë programet kompjuterike iu janë përshtatur programeve mësimore duke instaluar programet aplikative që kërkohen nga departamentet përkatëse mësimore. Duke ndjekur zhvillimet e reja teknologjike UART ka investuar në sisteme, të cilat e mbështesin studentin në procesin mësimor. Më konkretisht në sistemin PITAGORA, ky sistem bën të mundur që studenti në kohë reale të azhurnohet me materialet e hedhura nga pedagogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj. Ka mundësi të komunikojë nëpërmjet sistemit në forume të hapura me pedagogët si dhe kolegët e kursit që ndjek.; të shikojë notat dhe pikët on-line nga kudo që ndodhet.

### **Laboratorët dhe mjediset për realizimin e praktikës**

Fakulteti i Arteve të Bukura mundëson zhvillimin e shkollës doktorale duke vendosur në dispozicion të saj:

- 7 laboratore;
- 7 ateliere;
- 5 klasa/atelie.

Për vetë specifikën që ka ky fakultet po japim një përshkrim të gjitha mjedisëve që posedon FAB.



## **Laboratorit te Multimedia-s.**

Laboratori digjital është konceptuar që të jetë në disa hapsira të fakultetit që komunikojnë si një e vetme dhe në shtrirje kohore të paraplanifikuara në fillim të viti shkollor nga modulet e dy programeve (bachelor dhe atij master).

Laboratori është menduar të formohet nga një lidhje e softëar-ve, hardëar-ve, mjeteve të punës, hapësirave, stafit teknik dhe atij pedagogjik në ndihmë dhe të programeve të lartpërmendura. Laboratori do jetë një rrugëtim për studentët e arteve pamore që fillon me njohjen e programeve operativ bazë si ëindoës dhe os (mac), njohjen e programeve 2d dhe 3d, përdorimin e tyre, njohjen me edit-ing, playout etj.

Laboratori digjital është konceptuar që të jetë në disa hapsira të fakultetit që komunikojnë si një e vetme dhe në shtrirje kohore të paraplanifikuara në fillim të viti shkollor nga modulet e dy programeve (bachelor dhe atij master). Laboratori është formohet nga një lidhje e softëar-ve, hardëar-ve, mjeteve të punës, hapësirave, stafit teknik dhe atij pedagogjik në ndihmë dhe të programeve të lartpërmendura. Laboratori është rrugëtim për studentët e arteve pamore që fillon me njohjen e programeve operativ bazë si ëindoës dhe os (mac) , njohjen e programeve 2d dhe 3d, përdorimin e tyre, njohjen me edit-ing, playout etj.

Kerkesat teknike në listen e paraqitur si më poshtë, janë bazuar në referencat e laboratoreve Multimedial të Universiteteve që UAT Bashkëpunon dhe njëkohësisht duke u bazuar në standartet e prezantuara nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit mbi specifikimet teknike standarde për vitin kalendarik 2018.

Programet e studimit të shkollave të binjakezuara me Universitetin e Arteve, me shkollat e programit Erasmus+ ku studente të Universitetit të Arteve kryejnë një semestër, përdorin pajisje dixhitale: kompjutera iMac me sistem operativ Macintosh OS X, dhe tableta dixhitale Ecom. Duke qenë se duhen krijuar të njëjtat kushte standarde të studimit si për studentet e huaj të programit Erasmus+ ashtu edhe për studente shqiptare që kthehen nga këto programe studimit, nevojiten të njëjtat pajisje të markave dhe specifikave teknike të listuar në këto kërkesa.

Për shkak të hapësirave të laboratoreve ku do të vendosen pajisjet digjitale, Ekranet e kompjuterat me njësi të vetme nevojiten të jenë 21.5” (inches).

Arsye tjetër është që studentet duhet të mesohen me Hardëare-in e familjes Apple dhe njëkohësisht me komandat ndryshe nga PC që ofron në tregun e punës Softëari i MAC OS. (Mojave).

Programe të vecanta që studentet e degës së Multimedias dhe të Grafikdesign si: Final Cut Pro/ Millumin 2/ Logic Pro X etj. Instalohen dhe punojnë pa konflikte vetëm në Hardëare-t Mac.





1. Kandidati për gradën shkencore “Doktor”, fiton statusin e Doktorantit porsa regjistrohet në programin e studimeve të doktoraturës pranë FAB.
2. Statusi i doktorantit humbet mbas mbrojtjes së Temës së Dizertacionit, gjatë periudhës së pezullimit të studimeve dhe në momentin kur kandidati çregjistrohet nga studimet e doktoraturës.

### **Neni 37**

#### **Të drejtat e Doktorantit**

Kandidati për gradën shkencore “Doktor”, gjatë periudhës kur ka fituar statusin e doktorantit, gëzon të drejtat si më poshtë vijon :

1. Të përfaqësohet si student në organet e UART, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi apo kur ai është pjesë e stafit akademik të UART.
2. Të marrë pjesë si student në të gjitha proceset e vendimmarrjes së UART, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi apo kur ai është pjesë e stafit akademik të UART.
3. Të përdorë mjedise në auditorë, në klasa studimi, në studio, në atelie, në biblioteka, salla kompjuterësh, laboratorë, mjedise sportive dhe shërbime të tjera që ofrohen për studentët nga UART.
4. Të sigurojë burime të tjera financimi kur plotëson kushtet e përcaktuara nga aktet nënligjore në fuqi.
5. Të pajiset me diplomë, ose certifikatë në përfundim të një programi studimi, si dhe me të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme.
6. Bazuar në marrëveshjet institucionale, të marrë pjesë në programe studimi jashtë njësisë kryesore ku studion, të zhvillojë një apo më shumë semestra jashtë UART, si dhe ti njihen kreditet (ECTS), lëndët e zhvilluara apo veprimtaritë e tjera në kuadër të programit respektiv.
7. Të zhvillojë praktika mësimore, në institucione që kanë marrëveshje bashkëpunimi me UART apo njësitë kryesore.
8. Të pajiset me Kartën e Studentit dhe të përfitojë shërbime me çmime të reduktuara, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi, apo kur ai është pjesë e stafit akademik të UART.
9. Të organizohet në organizata jofitimprurëse brenda UART.
10. Të kërkojë ndryshimin e Udhëheqësit dhe/ose Bashkudhëheqësit.
11. Të modifikojë dhe/ose ndryshojë, vetëm një herë gjatë studimeve të doktoraturës, temën e doktoraturës.
12. Të pezullojë dhe/ose të çregjistrohet nga studimet e doktoraturës.



13. Të transferojë studimet e doktoratës pranë një IAL-je tjetër. Doktorantit që kërkon të transferojë studimet, pajiset edhe me dosjen që përmban të dhënat mbi punën kërkimore, në kuadër të studimeve për fitimin e gradës shkencore “Doktor”, deri në momentin e paraqitjes së kërkesës për transferim studimesh.

### **Neni 38**

#### **Detyrimet e Doktorantit**

Kandidati për gradën shkencore “Doktor”, gjatë periudhës kur ka fituar statusin e doktorantit, ka detyrim:

1. Të njohë dhe zbatojë Statutin e UART, Rregulloren e Studimeve të Doktoraturës dhe legjislacionin në fuqi për studimet e doktoratës.
2. Të respektojë Kodin e Etikës të UART.
3. Të sillet me korrektësi dhe të respektojë të drejtat e personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, si dhe të studentëve të tjerë.
4. Të përmbushë në kohën dhe afatet e caktuara, si dhe me cilësi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga programi i studimit dhe të marrë pjesë në gjithë veprimtaritë akademike që realizohen nga FAB dhe Njësia Bazë e Pikturës, në bashkërendim edhe me Njësitë Bazë në FAB në përputhje me kontratën e nënshkruar.
5. Të shlyejë, sipas afateve të përcaktuara dhe kontratës së nënshkruar, të gjitha detyrimet financiare ndaj Universitetit të Arteve dhe FAB.
6. Të tregojë kujdes dhe të mirëmbajë të gjitha asetet dhe objektet e mësimdhënies dhe të punës.

### **Neni 39**

#### **Sigurimi i Cilësisë**

1. Programi i studimit të doktoraturës i nënshtrohet vlerësimit periodik të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë.
2. Përgjegjësia e sigurimit të cilësisë së programit të studimit të doktoraturës i takon Komisionit të përhershëm për dhënie të Gradës shkencore “Doktor”, Udhëheqësit Shkencor, Bashkudhëheqësit, nëse ka, dhe vetë doktorantit.



**KREU VII**  
**DISPOZITA TË FUNDIT**

**Neni 40**

1. Çdo ndryshim i kësaj Rregullore miratohet nga Senati Akademik.
2. Universiteti nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e kësaj rregulloreje.
3. Rregullorja e Programit të Studimeve për fitimin e Gradës shkencore “Doktor” në Artet e Bukura hyn në fuqi pas miratimit të Senatit Akademik të Universitetit të Arteve.

